



FONDACIONI
SHOQËRIA
E HAPUR
PËR SHQIPËRINË

RAPORT MONITORIMI
ALTERTEKST
2012



RAPORT MONITORIMI **ALTERTEKST 2012**



FONDACIONI
SHOQËRIA
E HAPUR
PËR SHQIPËRINË

TABELA E PËRMBAJTJES

- 07 Hyrje**
- 09 Kampioni dhe metodologjia**
- 11 Përmbledhje e gjetjeve kryesore**
- 13 Vlerësimi dhe përzgjedhja e teksteve**
Nga Endrit Shabani
- 20 Cilësia e teksteve**
Nga Auron Pasha
- 30 Mekanizmi i përmirësimit të cilësisë së teksteve**
Nga Fatmir Bezati
- 37 Alterteksti dhe Matura Shtetërore**
Nga Endrit Shabani
- 38 Rekomandime**
- 41 Analizë krahasimore e monitorimit të Altertekstit gjatë tre vjetëve të fundit (2010 – 2012)**
Nga Endrit Shabani
- 41 Gjetjet e studimeve ndër vite të fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë**
- 45 Rekomandimet ndër vite të fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë**

FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË

Altertekst 2012 - Raport Monitorimi

ADRESA

Rr. Qemal Stafa, Pallati 120/2, Tirana, Albania

Tel: +355 4 22 34 621/ 22 34 223/ 22 35 856

Fax: +355 4 22 35 855

E-mail: info@soros.al

Web-page: www.soros.al

DESIGN & LAYOUT

Henrik Lezi

FJALË PËRSHËNDETËSE

Politika e tekstit shkollor mbart një peshë të rëndësishme në përcaktimin e cilësisë së arsimit dhe zhvillimit shoqëror të vendit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka ndërmarrë vitet e fundit reformën e “Altertekstit”, e cila liberalizoi procesin e hartimit, shtypjes dhe shpërndarjes së librit shkollor e për rrjedhojë rritjen e larmisë së teksteve.

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë duke njohur rëndësinë e këtij procesi ka ndërmarrë tre vitet e fundit një nismë periodike monitorimi rreth zbatimit të Altertekstit sikundër ka ka nxitur vazhdimisht diskutime midis grupeve të interesit dhe politikbërësve për të njohur problematikat me të cilat përballlet kjo reformë dhe për të përmirësuar zbatimin e saj.

Në këtë kuadër projekti “Zbatimi i Altertekstit nën Dritën e Monitorimit 2012” dhe raporti të cilin kam kënaqësinë ta ndaj me ju, synon qartësimin e zbatimit të praktikave dhe të procedurave të parashikuara në “Paketën Informuese Altertekst 2012-2013”. Raporti paraqet një mori të dhënash mbi një sërë etapash të administrimit të politikës së Altertekstit ashtu si dhe opinionet e mësuesve, nxënësve dhe prindërve lidhur me cilësinë e teksteve shkollore. Raporti paraqet gjithashtu një numër rekomandimesh drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës me synim përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullues dhe praktikës së këtij procesi të rëndësishëm. Rekomandimet mbështeten në gjetjet e sintetizuara të monitorimit gjatë vitit 2010, 2011, 2012 si dhe në sugjerimet e palëve të interesit të përfshira gjërësisht në tryezat e diskutimit të zhvilluara në kuadër të kësaj nisme.

Fondacioni, shpreson që përmes këtij raporti ti shërbejë ekspertëve të arsimit, prindërve, nxënësve, mësuesve dhe institucioneve arsimore në përfundimin e një pamje të plotë rreth ecurisë së reformës së Altertekstit gjatë tre viteve të shkuara e cila mund të ndihmojë në një orientim më të drejtë të vëmendjes dhe nxitjen e përmirësimit të kësaj reforme.

Prindërit, nxënësit dhe mësuesit përmes organizimeve të tyre duhet të angazhohen fuqimisht në shndërrimin e gjetjeve të monitorimit në përpjekje advokuese për të kërkuar përmirësimin e situatës.

ANDI DOBRUSHI

Drejtor Ekzekutiv

SHKURTIME

BOMIT – Bordi i Miratimit të Teksteve

DAR - Drejtoria Arsimore Rajonale

MASH - Ministria e Arsimit dhe e Shkencës

KMT – Komisioni i Miratimit të Teksteve

KVT – Komisioni i Vlerësimit të Teksteve

KPT - Komisioni i Përzgjedhjes së Teksteve

IKAP - Inspektoriati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar

VKM – Vendimi i Këshillit të Ministrave

OSFA- Open Society Fondation for Albania

PËRSHKRIM I PROCESIT TË ALTERTEKSTIT

Prej disa vitesh tashmë 650 000 nxënës të arsimit parauniversitar po mësojnë me tekstet alternative, një reformë kjo e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH). Reforma e teksteve alternative (Altertektst) synon liberalizimin e procesit të botimit të teksteve shkollore për arsimin parauniversitar, duke bërë që në treg të ketë disa tekste të ndryshme të së njëjtës lëndë, ndër të cilët mësuesit zgjedhin librin që u përshtatet më së miri.

Për të garantuar funksionimin e procesit është përgatitur kuadri i nevojshëm rregullues, si dhe janë ngritur struktura të caktuara për administrimin e procesit. Kështu, janë ngritur komisionet e vlerësimit të teksteve (KVT), të cilat bëjnë vlerësimin paraprak të teksteve që vijnë nga shtëpitë botuese. Në bazë të vlerësimit që bëjnë KVT-të, Komisioni i Miratimit të Teksteve (KMT) miraton tekstet që do të kenë të drejtën të shpërndahen nëpër shkollat fillore dhe të mesme. Më pas, në çdo shkollë, ngrihen komisionet e përzgjedhjes së teksteve (KPT), të përbëra nga mësuesit e lëndës, të cilët përzgjedhin tekstin me të cilin do të japin mësim gjatë vitit shkollor. Vendimet në KPT merren me shumicën e anëtarëve dhe pas marrjes së vendimit të gjithë mësuesit e lëndës (edhe ata që kanë votuar kundër) janë të detyruar që gjatë atij viti shkollor të përdorin këtë tekst mësimor. Ky proces përsëritet çdo vit të ri shkollor.

KAMPIONIMI DHE METODOLOGJIA

Monitorimi i Reformës së Altertektstit gjatë vitit 2012 u përqendrua në shtatë qytete të rëndësishme për nga pikëpamja e përfaqësimit të diversitetit gjeografik dhe social të popullatës (Tiranë, Shkodër, Kukës, Elbasan, Fier, Vlorë dhe Korçë), ndërkohë që përmes instrumenteve sasiore u grumbulluan të dhëna edhe në një shtrirje kombëtare.

Në kuadër të këtij monitorimi grupi i ekspertëve përzgjodhi metodologjinë dhe kampionin duke u bazuar në natyrën e procesit të “Altertektstit”, si dhe duke marrë në konsideratë aktorët e përfshirë në këtë proces. Ekspertët ndërtuan instrumente cilësore dhe sasiore, të cilat targetuan nxënësit, prindërit, mësuesit, drejtuesit arsimorë, si dhe përfaqësues të institucioneve arsimore në nivel vendor dhe qendror.

Anketa online është promovuar përmes rrjeteve sociale dhe është vizituar nga 15 873 nxënës të grupmoshës 13 – 19 vjeç dhe nga 10 246 prindër e mësues, nga të cilët janë plotësuar 2815 pyetësorë. Kampioni i të anketuarve online, pas filtrimit paraprak, është 2079 të anketuar, nga të cilët 736 janë prindër, 419 mësues dhe 963 nxënës.

Gjatë muajit tetor, në 7 qytetet e sipërcituara u zhvilluan 21 fokus-grupe me nxënës, mësues dhe prindër dhe në secilin fokus-grup morën pjesë 7 – 10 pjesëmarrës, sipas profileve të paracaktuara nga grupi i ekspertëve. Gjithashtu, u zhvilluan intervista të strukturuar me 14 drejtorë shkollash të mesme e 9- vjeçare, si dhe me përfaqësues të IKAP-it. Për realizimin e këtyre fokus-grupeve dhe intervistave, ekspertët e projektit hartuan profilet e pjesëmarrjes dhe guidat, të cilat u strukturuan sipas tematikave që mori në shqyrtim ky monitorim.

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE

VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E TEKSTEVE

Funksionimi i Komisionit të Miratimit të Teksteve (KMT) dhe i Komisionit të Vlerësimit të Teksteve (KVT)

- Edhe këtë vit anëtarët e KVT-ve kanë qenë anonimë për publikun, duke ushqyer kështu dyshimet e grupeve të interesit (mësuesve dhe prindërve) nëse këta anëtarë e kanë apo jo kualifikimin e nevojshëm.
- Transparenca e përbërjes së KVT-ve vlerësohet si një kusht i nevojshëm për të garantuar respektimin e kriterëve në përzgjedhjen e anëtarëve të këtyre komisioneve, si edhe për të rritur përgjegjësinë publike të anëtarëve të tyre përballë komunitetit. Ndërkohë duhet të mbahet parasysh se me hyrjen në fuqi të ligjit nr.69, të vitit 2012 “Për arsimin parauniversitar”, mospublikimi i emrave të anëtarëve të KVT-së është në kundërshtim me ligjin, i cili në nenin 47 përcakton se “përzgjedhja e teksteve shkollore duhet të bëhet përmes një procesi transparent”.
- Shqetësues është edhe fakti që veprimtaria e KVT-ve nuk është pjesë e kuadrit monitorues të IKAP-it, duke e bërë edhe më të pamundur monitorimin e veprimtarisë së këtyre komisioneve.
- Ndërkohë një pjesë e madhe e mësuesve pjesëmarrës në fokus-grupe akuzojnë KVT-të dhe KMT-në se të parët përzgjedhin dhe i dyti miraton tekste të një cilësie tepër të ulët dhe (shpesh) me gabime shkencore.

Funksionimi i KPT-ve

- Gjatë fokus-grupeve shpeshherë mësuesit shprehen se ata detyrohen të mos zgjedhin tekstet më të mira për shkak të ndikimit si nga jashtë, ashtu edhe nga brenda sistemit, për të favorizuar tekste të caktuara.
- Dyshime janë ngritur (nga grupet e interesit, por edhe nga raportet e IKAP-it) në lidhje me informimin paraprak të mësuesve për alternativat që do të votohen. Vetë mësuesit gjatë fokus-grupeve shprehen se shpesh kampionet e teksteve mbërrijnë shumë vonë dhe në sasi tepër të vogël (një tekst për shkollë), çka e bën të vështirë shqyrtimin/vlerësimin e të gjitha alternativave brenda kohës së përcaktuar, gjë që nuk i lejon mësuesit të krijojnë një mendim të pjekur lidhur me pikat e forta dhe të dobëta të secilit tekst alternativ.
- Në kuadër të ndryshimeve në Paketën Informuese “Altertekst 2012”, ku përcaktohet se KPT-të nuk duhet të përbëhen nga më shumë se 7 anëtarë, gjatë fokus-grupeve është raportuar se një numër i konsiderueshëm mësuesish (kryesisht mësues të rinj) janë

lënë jashtë këtyre komisioneve, duke mos u dhënë atyre mundësinë të zgjedhin tekstin me të cilin do të punojnë gjatë vitit shkollor.

- Megjithëse një detyrim ligjor, duket se pjesëmarrja e prindërve në mbledhjet e KPT-ve edhe këtë vit nuk është realizuar në masë të gjerë (96 % e prindërve të anketuar deklarojnë se nuk kanë qenë pjesë e KPT-ve), duke i lënë kështu ata jashtë procesit të përzgjedhjes së teksteve.

Cilësia e teksteve

- Nga vetë nxenesit¹ deklarohet se lëndët ku hasin më shumë vështirësi në përvetësimin e dijeve janë më së shumti lëndët ekzakte, por edhe gjuha e huaj. Ndërkohë që nga përgjigjet e prindërve të fëmijëve më të vegjël (cikli fillor 1-4) përveç Matematikës (73%) shfaqet dukshëm edhe Gjuha Shqipe (55%) dhe Gjuha e Huaj (32%) si lëndë ku fëmijët hasin vështirësi.
- “Cilësia e dobët e tekstit” konsiderohet si shkak kryesor i vështirësive të hasura në lëndë të ndryshme, me 36% të përgjigjeve. Ky shkak është më i madh se “Boshllëqet e krijuara në vite” me 31% apo përgatitja dhe përkushtimi i mësuesit, me 20% dhe 12% respektivisht.
- Kur janë pyetur për problemet kryesore që hasin me tekstet, nxënësit e shkollave të mesme përmendin: “Gjuhën e përdorur në tekst, e cila është e vështirë/e pakuptueshme” (24%), më pas shqetësimin se “Njohuritë në tekst nuk janë praktikë” (21%) dhe se “Njohuritë në tekst nuk kanë rrjedhë logjike” (19%). Ndërsa nxënësit e shkollave 9-vjeçare rendisin si problemin kryesor “Dijen në tekst, e cila është e një niveli më të përparuar se ai i moshës së tyre” (29%).
- Cilësia e dobët e teksteve është një çështje për të cilën nxënësit dhe prindërit janë të shqetësuar dhe diskutojnë edhe me mesuesit. Më shumë se 40% e nxënësve të anketuar deklarojnë se kanë diskutuar me mësuesit e tyre të lëndës dhe këta të fundit kanë pranuar se cilësia e tekstit është e dobët. Një shifër e ngjashme rezulton edhe nga anketa e prindërve.
- Për të kuptuar ecurinë e cilësisë së teksteve shkollore janë pyetur prindërit dhe 17% e tyre shprehen se, krahasuar me një vit më parë, cilësia e teksteve shkollore në përgjithësi ka qenë më e dobët, kurse 12% e tyre shprehen se cilësia është më e mirë këtë vit. Ndërsa pjesa dërrmuese e prindërve, 71 %, janë të mendimit se asgjë nuk ka ndryshuar këtë vit për sa i përket cilësisë së teksteve shkollore.
- Po ashtu, vetëm 24% e nxënësve deklarojnë se cilësia e teksteve për vitin akademik 2011-2012 ishte më e mirë se e vitit të mëparshëm. Pjesa më e madhe mendon se cilësia ishte njësoj me vitin e kaluar (56%) dhe 20% deklarojnë se cilësia ishte më e dobët.

1 Nxënësit e anketuar përfshijnë ata të klasës VIII të shkollës 9-vjeçare dhe kryesisht ata të shkollës së mesme.

Mekanizmi i përmirësimit të cilësisë së teksteve


- Drejtuesit e shkollave dhe të DAR-it pohojnë se në asnjë shkollë nuk ka një mekanizëm që funksionon për të mbledhur përshtypjet dhe opinionet e nxënësve për tekstet mësimore.
- Pjesa më e madhe e nxënësve të anketuar (91%) deklarojnë se nuk u është marrë mendim rreth cilësisë së teksteve shkollore.
- Po ashtu, edhe prindërit duket se nuk kanë pasur mundësi të shprehin opinionet e tyre për tekstet shkollore. Kështu, pjesa dërrmuese e prindërve të anketuar (95%) deklarojnë se nuk u është marrë mendim për cilësinë e teksteve
- Ndërkohë mendimi duket se nuk u është marrë as mësuesve, pasi 76% e mësuesve të anketuar deklarojnë se nuk u është marrë mendim për problemet apo vështirësitë që ata mund të kenë hasur me tekstet shkollore.

Vlerësimi dhe përzgjedhja e teksteve

ENDRIT SHABANI


Cilësia e teksteve konsiderohet një çështje tepër e rëndësishme, nisur edhe nga fakti se reforma e altermtekstit u ndërmor pikërisht për të siguruar tekste shkollore të një cilësie më të lartë. Prandaj janë mbledhur mendimet dhe përvojat e përdoruesve të teksteve (mësuesve, nxënësve dhe prindërve të tyre) për cilësinë e tyre. Megjithëse 24 % e nxënësve të anketuar mendojnë se cilësia e teksteve shkollore po shkon në rritje, pjesa më e madhe e tyre (53%) shprehën se në këtë vit shkollor ata kanë mësuar me të paktën një tekst të një cilësie të dobët. Të pyetur nëse e kanë diskutuar këtë shqetësim me mësuesin e lëndës, 69% e nxënësve dhe 68.2% e prindërve të anketuar pohojnë ta kenë bërë një gjë të tillë, por edhe ai (mësuesi) ndan të njëjtin mendim me ta për cilësinë e dobët të tekstit.

Grafik 1. 1. A ka ndonjë lëndë të vitit shkollor 2011-2012 për të cilën ju mendoni se cilësia e tekstit ka qenë e dobët?



Një e dhënë e tillë duket në pamje të parë si një paradoks, pasi janë vetë mësuesit e lëndës ata që zgjedhin tekstat shkollorë me të cilat do të mësojnë nxënësit. Por kur u hulumtua më thellë në këtë drejtim, rezultoi se një pjesë e madhe e mësuesve pjesëmarrës në fokus-grupe u shprehën se nuk ndihen të lirë në procesin e përzgjedhjes së teksteve. Nisur nga këto pohime duket se ekziston risku që interesi i lartë ekonomik, që qëndron mbas këtij procesi, mund të nxisë disa shtëpi botuese, të cilat të ndihmuara edhe nga lidhjet me drejtues me ndikim brenda sektorit të arsimit, të influencojnë procesin e përzgjedhjes së teksteve duke kufizuar lirinë e mësuesve për të zgjedhur tekstin që ata e gjykojnë si më të përshtatshëm.

Grafik 1.2. A keni diskutuar me mesuesin e lëndës në lidhje me cilësinë e dobët të këtyre teksteve?




Komisionet e vlerësimit të teksteve (KVT-të) përbëjnë filtrin e parë të alartekstit, por, megjithë rëndësinë e madhe që ka veprimtaria e këtyre komisioneve, edhe këtë vit MASH-i ka ndjekur politikën e ruajtjes së anonimatit për personat që marrin pjesë në këto komisioneve, me argumentin se në këtë mënyrë i mbrojnë ata nga çdo ndikim i mundshëm. Megjithatë pritshmëria është që këto komisione të përbëhen nga njohës të mirë të lëndëve përkatëse, të cilët mund të jenë mësues apo pedagogë, respektimi i një kërkesë të tillë mbetet për t'u vërtetuar. Shqetësime janë ngritur pothuajse në të gjitha fokus-grupet e realizuara me mësues dhe prindër, mbi mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të KVT-ve, kriteret mbi të cilat është bazuar kjo përzgjedhje, si dhe nëse është ndjekur apo jo ndonjë politikë për kufizimin e konfliktit të interesit. Ndërkohë që nga intervistat e realizuara me përfaqësues të IKAP-it rezultojnë se veprimtaria e KVT-ve dhe KMT-së nuk monitorohet nga kjo strukturë, duke i vendosur këto komisione në një zonë krejt të errët për publikun.

Në kushtet e një mungese të tillë informacioni mbi funksionimin e këtyre komisioneve, pjesa dërrmuese e mësuesve pjesëmarrës në fokus-grupe e drejtojnë gishtin nga KVT-të për çështjen e cilësisë së teksteve shkollore, duke i akuzuar ata për mungesë profesionalizmi, madje edhe për korrupsion. Mësuesit, gjithashtu, akuzojnë edhe Komisionin e Miratimit të Teksteve (KMT-në), duke ngritur pikëpyetje se si është e mundur që ky komision ka miratuar për botim disa tekste shkollore që (sipas mësuesve) përmbajnë gabime të theksuara shkencore, për të cilat ata sollën edhe detaje dhe raste konkrete.

Një qëndrim të ngjashëm duket se kanë edhe prindërit. Vetëm 3.5 % e prindërve të

anketuar e konsiderojnë procesin e vlerësimit dhe miratimit të teksteve nga MASH-i si shumë transparent, ndërkohë që 60.6% e tyre e konsiderojnë procesin aspak transparent dhe 35.9%, deri diku transparent.

Grafik 1.3. Si e vlerësoni procesin e përzgjedhjes së teksteve mësimore nga Ministria e Arsimit dhe mësuesit e lëndës?



“Shpeshherë arsyeja se pse një tekst është zgjedhur me gabime shkencore kërkohet te mësuesit. Po ky teks,t derisa ka ardhur në dorën e mësuesit, ka kaluar shumë pragje të tjera dhe është çertifikuar nga një komision i miratimit të teksteve në ministri. Mësuesit i thonë pse e ke zgjedhur me gabime shkencore. Po ti, që je i pari atje, pse ia ke dhënë certifikatën të kalojë deri te mësuesi?”

MËSUES NË KORÇË

Në konceptimin fillestar, në qendër të reformës së Altertekstita ka qenë liria e mësuesit për të zgjedhur tekstin më të përshtatshëm për zhvillimin e procesit të mësimdhënies, por në terren duket se gjërat nuk qëndrojnë gjithnjë kështu. Nga fokus-grupet është vënë re se jo të gjithë mësuesit kanë qenë pjesë e KPT-ve, pasi këtë vit është ndjekur një politikë e tillë, që ka lënë jashtë përzgjedhjes një pjesë të tyre. Një sjellje e tillë duket se vjen ngaqë në paketën informuese “Altertekst 2012” (pika II, 6 gërma “c”) për herë të parë u përcaktua se KPT-të nuk mund të përbëhen nga më shumë se 7 mësues (por as më pak se 5 mësues). Një

detyrim i tillë ka bërë që në konfigurimet e mundshme për formimin e KPT-ve, disa mësues të lihen jashtë këtyre komisioneve. Mësuesit pjesëmarrës në fokus-grupe kanë sjellë shumë raste ku, pasi janë formuar grupe prej 7 mësuesish, mësuesit e tjerë të asaj lënde janë lënë jashtë komisionit, dhe për pasojë jashtë procesit vendimmarrës. Ndërkohë gjatë intervistave me drejtuesit arsimorë të pyetur mbi këtë fakt, ata, megjithëse nuk kanë shpjeguar arsyet që kanë çuar në një situatë të tillë, janë përpjekur të sigurojnë se këta mësues, pavarësisht se nuk marrin pjesë në KPT, arrijnë gjithësesi ta shfaqin mendimin e tyre në mbledhjet e tjera që zhvillohen brenda shkollës. Duam të theksojmë se në çdo rast një veprim i tillë deformon në thelb qëllimin e alterteksit, pasi lë krejtësisht jashtë procesit të përzgjedhjes një pjesë të mësuesve.

Ndërkohë, në mënyrë që mësuesit të vlerësojnë se cili tekst është më i përshtatshmi, së pari do të duhej që ata t'i lexonin këto tekste. Por një proces i tillë, sado i thjeshtë që të duket në pamje të parë, mund të mos jetë gjithnjë i mundur. Kështu, është evidentuar gjatë këtij studimi se edhe këtë vit, përveç faktit që në shkolla nuk dërgohet një sasi e mjaftueshme tekstesh për secilën prej alternativave (në disa raste sigurohet vetëm një tekst për shkollë), edhe koha që u lihet në dispozicion mësuesve për ta shqyrtuar këtë tekst është shumë e shkurtër. Një gjë e tillë vë në pikëpyetje faktin nëse të gjithë mësuesit i lexojnë vërtet të gjitha alternativat e paraqitura përpara se të votojnë se cila prej tyre është më cilësorja. Kjo çështje bëhet veçanërisht pengesë për tekstet që konkurrojnë për herë të parë, pasi, nëse KPT-të nuk do t'i shqyrtojnë këto alternativa, atëherë konkurrimi i drejtë i tyre do të ishte thujasë i pamundur.

“Në fakt është një sëmundje e përgjithshme, që duhet ta themi, është e hidhur por duhet ta themi. Në tërësi ka një problem: e reja hyn me vështirësi. Ka tekste shumë të mira bashkëkohore, por nuk na bie radha t'i lexojmë, bëjmë pjesën formale dhe nuk e shohim këtë informacion”.

MËSUES NË FIER

Dyshime nëse mësuesit i lexojnë vërtet të gjitha alternativat që u paraqiten, janë ngritur edhe në raportin e IKAP-it mbi ecurinë e Alterteksit. Rezulton se nga kontrollet e zhvilluara nga ky institucion procesverbalet e mbledhjeve të KPT-ve pasqyrojnë diskutime vetëm për alternativën fituese, ndërkohë që nuk raportohet asnjë diskutim për alternativat e tjera. Një rezultat i tillë nga njëra anë mund të jetë tregues i mosmbajtjes së rregullt të procesverbaleve, sikurse mund të jetë edhe tregues i faktit se përzgjedhja e teksteve shkollë mund të bëhet para peshimit të cilësisë së secilës prej alternativave të parashtruara në një KPT. Megjithatë, në të dyja rastet mbajtja e procesverbalit të mbledhjes së KPT-së është një proces shumë i rëndësishëm për transparencën e përzgjedhjes së teksteve, ndaj kërkohet një vëmendje më e nga MASH-i dhe institucionet vartëse.


“Nuk ka kohë fizike për t’i kaluar të gjitha, atëherë bëhen zgjidhje të pjesshme. Merren të gjitha alternativat si e ka trajtuar njëri, tjetri, tjetri, tjetri dhe kjo bëhet për disa mësim, se të gjitha tekstet nuk i dallojmë dot. Vetëm do të shikosh të njëjtën temë mësimore si e kanë trajtuar të pesta shtëpitë botuese.”

MËSUES NË KUKËS

Përveç rasteve të deklaruara në pjesën dërrmuese të fokus-grupeve me mësues, raste konkrete të ndërhyrjes së drejtuesve arsimorë në procesin e përzgjedhjes ka zbuluar edhe IKAP-i. Kështu, në vitin 2012 ky institucion ka verifikuar raste konkrete ku drejtuesit arsimorë të DAR/ZA-ve u kanë dhënë mësuesve udhëzime për të përzgjedhur tekste të caktuara. Po të mbajmë parasysh rolin e rëndësishëm që ka drejtuesi i DAR/ZA-së në karrierën e drejtorëve të shkollave dhe të mësuesve, atëherë mund të deduktojmë se ka pak gjasë që mësuesit të zgjedhin një tekst tjetër, veç atij për të cilin janë udhëzuar. Një rrethanë e tillë rëndohet akoma më shumë nga realizimi i votimit të hapur (jo të fshehtë) brenda mbledhjeve të KPT-ve, gjë e cila është konfirmuar nga pjesa dërrmuese e mësuesve pjesëmarrës në fokus-grupe.

Por mbi të gjitha mbetet për t’u hulumtuar roli që luan MASH-i në lidhje me mirëfunksionimin e Altertekstit. Është evidentuar se MASH-i është në dijeni të rasteve ku drejtues arsimorë kanë dhënë udhëzime për përzgjedhjen e teksteve të caktuara, përmes raporteve që ka depozituar IKAP-i, megjithatë mbetet për t’u vërtetuar nëse MASH-i ka marrë apo jo masa ndëshkuese ndaj këtyre drejtuesve. Jo në pak raste është ngritur pyetja nëse problemet e Altertekstit lindin në bazë (aty ku kontrolli i MASH-it mund të jetë më i zbehtë) apo fillojnë që në zemër të këtij institucioni, për t’u reflektuar më pas në të gjitha hallkat pasuese.

Grafik 1.4. A jeni në dijeni të mënyrës se si përzgjidhen tekstet me të cilat ju mësoni?



Në një kohë që një pjesë e konsiderueshme (36%) e nxënësve të anketuar janë shprehur se për shkak të cilësisë së keqe të disa teksteve shkollore, ata kanë vështirësi në përvetësimin e mësimëve, shkolla i ka mbajtur ata dhe prindërit e tyre larg procesit të përzgjedhjes së teksteve. Kështu 63% e nxënësve të anketuar shprehen se nuk kanë dijeni për mënyrën se si zgjidhen tekstet shkollore me të cilat ata mësojnë. Ndërkohë, prindërit, kur janë pyetur nëse kanë qenë ndonjëherë pjesë e KPT-ve në shkollën ku studion fëmija i tyre, vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve (4%) është përgjigjur pozitivisht. Një gjetje e tillë bëhet edhe më shqetësuese po të mbajmë parasysh se ligji i ri i arsimit parauniversitar (nr.69, viti 2012), që ka hyrë në fuqi që vitin e shkuar, parashikon (në nenin 47) pjesëmarrjen e prindërve në mbledhjet e KPT-ve. Por mësuesit dhe drejtuesit arsimor, ndërkohë që konfirmojnë mospjesëmarrjen e prindërve në KPT, bëjnë përgjegjës për këtë prindërit, duke u shprehur se kjo ka ndodhur ngaqë ata janë të paimentuar për t'u përfshirë në këtë proces.

Në paketën informuese “Altertekst 2012” (pika II.6, gërma “y” dhe “z”) parashikohet që gjatë vitit shkollor KPT-të duhet të bëjnë oponencën e teksteve shkollore (madje edhe gjatë pushimeve) dhe të dërgojnë në DAR/ZA të gjitha vërejtjet e tyre, të cilat më pas (përmes DAR/ZA-së) i dërgohen KMT-së. Për të hulumtuar këtë aspekt janë pyetur mësuesit pjesëmarrës në fokus-grupe, si dhe drejtorët e shkollave dhe përfaqësuesit e DAR-eve të intervistuar. Ajo që ka rezultuar ka qenë se praktikisht komentet nga KPT-të janë shumë të rralla dhe ndërkohë nuk ekziston asnjë mekanizëm tjetër sistematik i vjeljes së përshtypjeve të përdoruesve të tekstit. Një mekanizëm i tillë do të ishte shumë i rëndësishëm jo vetëm për të ndihmuar në procesin e rizgjedhjes së tekstit, por mbi të gjitha do të mund të mbushte vakuumin që krijohet nga mungesa e pjesëmarrjes së prindërve apo nxënësve në këtë proces, pasi, duke u dhënë rëndësi mendimeve të tyre, do t'i bënte ata pjesë të vendimmarrjes.

Duket se për shkak të gjithë problemeve të identifikuar më lart, por edhe të tjerave të pa parashtruara, pjesa më e madhe e mësuesve, nxënësve dhe prindërve, të pakënaqur me mënyrën se si kjo reformë po administrohet, shprehen se “do të preferonim më tepër të kishte një tekst të vetëm për të gjitha shkollat” sesa të vazhdohej në këtë mënyrë, duke deshmuar kështu kundërshtinë e tyre kolektive ndaj të gjithë sistemit të Altertekstit. Ndërkohë vlen për t'u theksuar se pavarësisht ankesave që kanë ndaj mënyrës se si po administrohet sistemi, as mësuesit edhe as prindërit nuk janë aktivë sa i përket denoncimit të problemeve në institucionet përkatëse. Kështu, rezulton se pranë IKAP-it ankesat për abuzime me procesin e vlerësimit, miratimit dhe përzgjedhjes së teksteve vijnë vetëm nga shtëpitë botuese, të cilave u dëmtohen interesat ekonomike nga konkurrenca e pandershme.

Cilësia e teksteve

AURON PASHA

Reforma e Altertekstit ka pasur si synim kryesor rritjen e cilësisë së teksteve mësimore. Mekanizmat e ngritur për përzgjedhjen e tyre kanë procedura specifike për vlerësimin e teksteve, por në fund ata që duhet të vlerësojnë këtë cilësi janë ata që e përdorin tekstin shkollor për të përfituar dije. Këtu futen së pari nxënësit dhe së dyti prindërit e tyre, sidomos ajo pjesë që ndihmojnë aktivisht fëmijët në përgatitjen mësimore. Për këtë arsye, studimi u fokusua te vjelja e mendimeve dhe opinionëve të këtyre grupeve të interesit. Bazuar në bisedat dhe raportimet në fokus-grupe të ndryshme, më poshtë renditen parametrat që janë vlerësuar nga nxënësit, prindërit dhe mësuesit për të përcaktuar një tekst me cilësi të lartë.


Tabela 2.1. Parametrat e vlerësuar nga nxënësit, prindërit dhe mësuesit për të përcaktuar një tekst me cilësi të lartë

Përmbajtja	Forma
<ul style="list-style-type: none">• Të jetë i përmbledhur (pa shumë ujëra)• Të jetë i përshtatshëm për moshën së cilës i drejtohet• Me gjuhë të kuptueshme, pa huazime termash/terminologjish të huaja• Të ketë rrjedhë logjike• Të mund të ndiqet/kuptohet nga nxënësi edhe në mungesë të mësuesit• Pamja vizuale t'i përshtatet dhe t'i shtojë vlerë përmbajtjes• Të japë dijeni në mënyrë/formë argëtuese	<ul style="list-style-type: none">• Të jetë me letër cilësore• Të jetë i fortë/të mos shkëputen fletët• Të jetë me ngjyra cilësore, të dallueshme• Të jetë me gërma të qarta dhe me hapësira/i lexueshëm Pa gabime drejtshkrimore


Në anketën online nxënësit u pyetën në lidhje me lëndët ku ata kanë hasur më shumë vështirësi në përvetësimin e dijeve. Qëllimi i kësaj pyetjeje ishte të krijonte një ide mbi grupin e lëndëve më “problematike”, pavarësisht nëse kjo problematikë shkaktohet nga cilësia e tekstit apo shkaqe të tjera (cilësia e mësimdhënies, vështirësia e lëndës etj.)

Lëndët ekzakte në përgjithësi janë ato që më së shumti pritet të krijojnë probleme te nxënësit në përvetësimin e mësimëve për shkak të natyrës së vetë lëndës. Dhe pikërisht Matematika(33% e të anketuarve), Kimia(21%) dhe Fizika(19%) janë lëndët e përmendura më shumë nga nxënësit e shkollave të mesme, si lëndët ku hasen më shumë vështirësi në përvetësimin e dijeve. Për nxënësit e shkollave 9-vjeçare, përveç Matematikës (39%) dhe Kimisë (19%) përmendet edhe Gjuha e Huaj (14%).

39%   MATEMATIKË



33% 

6%   FIZIKË

19% 

4%   HISTORI

3% 

1%   BIOLOGJI

4% 


2%   LETËRSI

2% 

19%   KIMI

21% 

14%   GJUHË E HUAJ

8% 

5%   GJUHË SHQIPE


2% 

5%   GJEOGRAFI

1% 


2%   ARTE

2% 

SHKOLLËN 9- VJEÇARE 

SHKOLLËN E MESME 

JU LUTEM PËRMENDNI LËNDËN KU
KENI HASUR MË TEPËR VËSHTIRËSI?



Lëndët ekzakte përmenden si lëndë ku nxënësit hasin vështirësi, bazuar edhe në pohimet e prindërve të anketuar. Por duke i ndarë prindërit sipas nivelit të shkollës ku shkojnë fëmijet e tyre, del se për nivelet e ciklit të ulët (klasa 1-4) dhe ato të ciklit të dytë të shkollës 9-vjeçare (klasa 5-9), përveç lëndëve ekzakte, edhe Gjuha Shqipe dhe Gjuha e Huaj përmenden ndër lëndët ku hasen vështirësi. Rreth 55% e prindërve të anketuar, të cilët deklarojnë se kanë fëmijë në ciklin fillor 1-4 dhe 58% e atyre me fëmijë në ciklin 5-9 thonë se Gjuha Shqipe është një lëndë ku fëmija has vështirësi në përvetësimin e dijeve. Po kështu rreth 32% e atyre me fëmijë në ciklin 1-4 dhe 39% e atyre me fëmijë në ciklin 5-9 deklarojnë se fëmijët kanë vështirësi në lëndën e Gjuhës së Huaj.


Tabela 2.2 Lëndët ku fëmija ka hasur vështirësi sipas cikleve shkollore – Përgjigjet e prindërve

Lënda	Cikli Fillor 1-4	Cikli II 5-9	Shkollë e mesme
Gjuhë Shqipe	54.7%	57.2%	41.2%
Matematikë	60.7%	51.4%	41.2%
Histori	13.7%	23.2%	23.5%
Gjuhë e huaj	12.8%	17.4%	17.6%
Kimi	4.3%	12.3%	27.5%
Letërsi	9.4%	10.9%	21.6%
Fizikë	4.3%	14.5%	25.5%
Dituri	12.8%	11.6%	0.0%
Edukatë Shoqërore/Qytetari	7.7%	9.4%	7.8%
Gjeografi	4.3%	10.1%	7.8%
Biologji	2.6%	5.1%	7.8%
Tjetër	7.7%	5.1%	0.0%
TIK	0.0%	0.0%	9.8%
Ekonomi	0.9%	0.0%	3.9%
Informatikë/teknologji	2.6%	0.7%	0.0%
Arte (muzikë, pikturë etj.)	2.6%	0.0%	2.0%
Shkencë toke	0.0%	1.4%	3.9%
Shkencë natyre	0.0%	0.7%	3.9%
Total	117	138	51

Më pas studimi ka mundur të thellohet për të kuptuar shkaqet kryesore se përse nxënësit kanë hasur vështirësi në këto lëndë. Bazuar në deklaratimet e nxënësve të anketur, arsyeja kryesore e vështirësisë së hasur në përvetësimin e dijeve të atyre lëndëve është “ Cilësia e teksteve”, e pohuar nga rreth 36% e tyre. Pra, **në çdo 3 nxënës 1 deklaron se ka hasur probleme në përvetësimin e një lënde për shkak të cilësisë së tekstit.**

“Boshllëqet e krijuara ndër vite” vjen me pas, e zgjedhur nga 31% e të anketuarve, e ndjekur nga “Përgatitja e mësuesit”, e zgjedhur nga 20% e të anketuarve. Rezultatet tregojnë se cilësia e teksteve është një çeshtje shumë e hasur, e diskutuar midis nxënësve dhe një problem i matshëm, gjë e cila ka rezultuar edhe gjatë fokus-grupeve të zhvilluara me prindër dhe nxënës.

Grafiku 2.1 A mund të thoni cili është shkaku kryesor për vështirësitë e hasura në këtë lëndë?



“Ka shumë libra, shumë autorë. Dëmi i vërtetë na behet ne. Brendia lë shumë për të dëshiruar. Nëse i sheh librat tanë, janë një miks përkthimesh i keq. Modele të huazuara nga vende të ndryshme dhe asgjë konkrete e bërë nga vetë ne. Janë një miks i keq.


NXËNËSE, TIRANË

Në përgjithësi, nisur nga rezultatet e anketës online, rezulton se ka një masë kritike nxënësish që mendojnë se ka tekste me cilësi të dobët në lëndë të ndryshme.

Më shumë se gjysma e nxënësve të anketuar, që frekuentojnë shkollën e mesme (56%), kanë deklaruar se mund të përmendin të paktën 1 (një) lëndë të vitit shkollor 2011-2012, për të cilën mendojnë se cilësia e tekstit ka qenë e dobët. Kjo shifër është 46% për nxënësit që frekuentojnë shkollën 9-vjeçare (vitin e 9-të).

Nxënësve të anketuar, që kanë përmendur të paktën një lëndë me cilësi të dobët të tekstit, u është kërkuar të përmendin lëndët specifike ku cilësia e tekstit është e dobët dhe ata që studionin në shkollën e mesme kanë përmendur lëndët ekzakte, si: Fizikë (46%), Kimi (41%) dhe Biologji (21%), por edhe Letërsinë (17%) dhe Historinë (16%). Ndërsa ata që studionin në shkollën 9-vjeçare, përveç lëndëve të përmendura më sipër, shtojnë edhe Matematikën (39% e tyre).


Grafiku 2.2 Ju lutemi përmendni lëndët ku cilësia e tekstit ka qenë e dobët - nxënësit



Kur nxënësit janë pyetur për problemet e teksteve, nxënësit e shkollës së mesme rendisin “Gjuhën e përdorur, e cila është e vështirë/e pakuptueshme” (24%), më pas rendisin shqetësimin që “Dijet/njohuritë në tekst nuk janë praktike” (21%), si dhe që “Dijet/njohuritë në tekst nuk kanë rrjedhë logjike” (19%).


Ndërsa nxënësit e shkollave 9-vjeçare të anketuar rendisin si problemin kryesor “Dijen në tekst, e cila është e një niveli më të përparuar se e moshës së tyre” (29%).

Grafiku 2.3 Ju lutemi zgjidhni problemin kryesor që keni hasur me keto tekste. Përgjigjet e nxënësve



Qëndrime të ngjashme dallohen edhe në përgjigjet e prindërve, ku ndër problematikat e hasura me tekstet spikasin më shumë arsye, si: “Dija në tekst nuk ka rrjedhë llogjike” (25%), “Dija në tekst nuk është praktike” (23%) apo “Gjuha e përdorur është e vështirë/e pakuptueshme” (18%)

SHKOLLË E MESME



GJATË PUNËS APO DISKUTIMIT ME FËMIJËN PËR KËTË ÇËSHTJE, A MUND TË ZGJIDHNI PROBLEMIN KRYESOR QË ËSHTË HASUR ME KËTO TEKSTE? PËRGJIGJET E PRINDËRVE


A. DIJA (NJOHURITË) NË TEKST NUK KANË RRJEDHË/LIDHJE LOGJIKE

B. DIJA (NJOHURITË) NË TEKST NUK JANË PRAKTIKE


C. GJUHA E PËRDORUR ËSHTË E VËSHTIRË/E PAKUPTUESHME

D. DIJA (NJOHURITË) NË TEKST NUK JANË KONKRETE/JANË ABSTRAKTE



E. DIJA (NJOHURITË) NË TEKST JANË TË NJË NIVELI MË TË PËRPARUAR PËR MOSHËN E FËMIJËS TIM



CIKLI II 5-9



CIKLI FILLOR 1-4



Të dhënat e përftuara përmes anketave online të zhvilluara me nxënës dhe prindër, konfirmohen edhe nga pjesëmarrës në fokus-grupe, ku është synuar të hulumtohet më në thellësi lidhur me problemet e identifikuar nga anketa. Për më tepër, gjatë fokus-grupeve maturantët sjellin edhe shembuj konkretë për ankesat e tyre. Kështu, për të ilustruar ankesën e tyre se ka tekste që nuk marrin parasysh formimin e mëparshëm të nxënësit, duke qenë të konceptuar për nivele më të larta njohurish, ata i referohen kapitullit mbi gjenetikën në tekstin Biologjia 10. Këto njohuri për nxënësit pjesëmarrës në fokus-grupe jo vetëm që konsiderohen si tejet të avancuara për nivelin e njohurive të mëparshme të nxënësve, por, gjithashtu, paraqesin edhe mangësi shembujsh në librin e ushtrimeve, ndërkohë që ushtrime të tilla do të bien në provimet e Maturës Shtetërore.

Një ankesë tjetër e ardhur nga nxënësit pjesëmarrës në fokus-grupe lidhet me tekstet shkollore të përkthyer nga gjuhët e huaja, të cilat sipas tyre kanë një përkthim të dobët, duke e bërë tekstin krejt të pakuptueshëm për nxënësit. Një shembull i sjellë nga ta është Biologjia 11, e përkthyer nga italishtja, ku raportohet se shumë terma nuk perputhen me librat përgatitorë me ushtrime. Probleme me terminologjinë e pashqipëruar janë raportuar edhe nga mësuesit pjesëmarrës në fokus-grupe, të cilët sjellin shembullin e tekstit Trashëgimia Kulturore, që sipas mësuesve përmban një mori termash në anglisht.

“Tekstet nuk kanë rrjedhshmëri, d.m.th ti në klasën e tetë merr botimin e një autori tjetër, që normalisht ka një këndvështrim tjetër dhe merr historinë e klasës së pestë, të gjashtë, shtatë dhe është një grup autorësh që kanë një lloj këndvështrimi të ndryshëm (patjetër që tekstet përputhen me programet e përcaktuar nga MASH-i, por këndvështrimi është i ndryshëm. Kujt i merret mendimi për këtë? Mendimi merret direkt nga drejtorja arsimore, nga persona të caktuar dhe ne si prindër, dhe unë kam qenë edhe në bordin e prindërve, jam kryetare bordi në një nga shkollat, nuk na merret mendimi.

PRIND FËMIJE – FIER.

“... nuk i përshtatet terminologjia e tekstit moshës me të cilët jepet ai tekst. Shumë herë e shikoja vajzën, edhe tani në klasë të dytë, në gjuhën shqipe, që është një skandal më vete, që i duhej të punonte me fjalor sikur po mësonte anglisht.”

PRIND FËMIJE – FIER

Sipas rezultateve të anketës online duket se nxënësit dhe prindërit e tyre e kanë diskutuar problemin e cilësisë së dobët të teksteve me mësuesit e lëndës. Kështu, rreth 69% e nxënësve të anketuar, të cilët kanë hasur probleme me tekstet, deklarojnë se kanë diskutuar me mësuesit dhe këta të fundit e kanë pranuar cilësinë e dobët të tyre. Në mënyrë të ngjashme, 68% e prindërve të anketuar, që kanë pranuar se fëmijët e tyre kanë pasur probleme me tekstet, deklarojnë se mësuesit kanë pranuar problemin gjatë diskutimeve me ta. Nëse këtë

numër e projektojmë mbi numrin total të prindërve, atëherë del se 41% e tyre kanë folur me mësuesit e lëndës dhe këta kanë pranuar cilësinë e dobët të tekstit të lëndës së tyre. Kjo është një shifër serioze, që tregon se cilësia e dobët e teksteve është dukuri e përhapur dhe e pranuar edhe nga vetë mësuesit.

Gjetjet e përfutuara përmes anketave online, konfirmohen vazhdimisht edhe përmes metodave cilësore të kërkimit, siç janë fokus-grupet dhe intervistat. Shumë nxënës deklarojnë se mësuesit e tyre e pranojnë faktin që teksti është me cilësi të dobët dhe me defekte. Në shumë raste mësuesit japin mësim me shënime, duke u perpjekur të rregullojnë gabimet ose mungesat e një teksti. Në disa raste ka ndodhur që pas përdorimit për një kohë të caktuar të një teksti, mësuesit kanë vendosur ta ndryshojnë atë me qëllim që nxënësit të mos vazhdojnë t'i marrin mësimet me shënime, por të mund të fokusohen më shumë tek teksti.

“Mungon një ditë dhe je i detyruar ta mesosh vetë. Pa qenë në klasë ose pa mësuesin, është shumë e vështirë. E para se janë koncepte të vështira dhe thelbi, ai që duhet të mësojmë, nuk është. Vetë mësuesit tanë e pranojnë. Ne shumicën e mësimeve i marrim me shënime, biles janë mësuesit vetë që thonë se libri ka këtë e atë problem.”

NXËNËS, SHKOLLE E MESME, TIRANË

“Kimia e klasës së tetë ka qenë një skandal më vete. Unë e diskutoja me një zysh që është zysh kimie shumë e vjetër dhe më thoshte “Une nuk di se si mund ta japin mësuesit këtë lloj kimie.” Një mësim i merr acidet dhe hyn në kiminë organike. Pastaj mesimi pasardhës hyn te kimia inorganike. Më fal pak ai duhet të trajtohet në një kapitull më vete.


PRIND FËMIJE, TIRANË

Sipas anketës, cilësia e dobët e tekstit ka ndikuar për keq në notën që kanë marrë nxënësit në këtë lëndë. Rreth 81% e nxënësve të anketuar, që kanë pohuar probleme me cilësinë e teksteve, deklarojnë se kjo ka ndikuar për keq në notën e tyre. E projektuar mbi totalin e nxënësve të anketuar, **rezulton se në çdo 3 (tre) nxënës, 1 (një) deklaron se jo vetëm cilësia e teksteve është e dobët, por edhe se kjo cilësi ka ndikuar për keq në notën që kanë marrë ata në lëndët respektive.**

Duke krahasur tekstet e vitit shkollor 2011-2012 me ato të një viti më parë, del se vetëm 24% e nxënësve të anketuar deklarojnë se cilësia e tyre është më e mirë, e ndjekur kjo nga 56% e tyre që deklarojnë se janë njësoj dhe 21%, që shprehen se cilësia e teksteve aktuale është më e dobët se një vit më parë. Ky vlerësim nuk ndryshon ndërmjet nxënësve të shkollës së mesme

dhe atyre të shkollës 9-vjeçare. Për sa u përket prindërve, vetëm 12% e tyre deklarojnë se cilësia e teksteve të fëmijëve të tyre është më e mirë gjatë vitit shkollor 2011-2012 krahasuar me një vit më parë, ndërsa 17% deklarojnë se cilësia e teksteve është më e dobët. Ndërkohë pjesa dërrmuese e prindërve të anketuar (71% e tyre) nuk shohin asnjë ndryshim këtë vit në cilësinë e teksteve shkollore.

Grafiku 2.4 Krahasuar me një vit më parë, cilësia e teksteve në përgjithësi këtë vit si ka qenë? Përgjigjet e nxënësve



Mekanizmi i përmirësimit të cilësisë së teksteve


FATMIR BEZATI

Përmirësimi i cilësisë së teksteve shkollore është një kërkesë e vazhdueshme dhe legjitime e përdoruesve të teksteve dhe për rrjedhojë duhet të jetë dhe përparësi e institucioneve arsimore. Për këtë arsye gjatë këtij studimi janë bërë përpjekje për të evidentuar funksionimin e ndonjë mekanizmi për vjeljen e përshtypjeve të përdoruesve të teksteve.

VJELJA E MENDIMIT TË NXËNËSVE

Përmes anketës online nxënësit u pyetën nëse u është marrë mendimi për cilësinë e teksteve shkollore të përdorura në këtë vit shkollor, në mënyrë që të mësonim rreth ekzistencës ose jo të një mekanizmi të mbledhjes së përshtypjeve për cilësinë e teksteve shkollore. Rezultoi se 91% e nxënësve të anketuar u përgjigjën negativisht dhe vetëm 9% e tyre u përgjigjën se janë pyetur lidhur me cilësinë e teksteve shkollore. Të dhëna të tilla janë mbështetur edhe nga pohimet e nxënësve pjesëmarrës në fokus-grupet e organizuara në 7 qytetet kryesore të vendit.

Grafiku 3.1 Gjatë këtij viti shkollor a ju ka marrë njeri mendim për cilësinë e teksteve shkollore? - Përgjigjet e nxënësve




“Zakonisht nuk na marrin mendim për asgjë. Kjo është e meta më e madhe e arsimit në Shqipëri.”

NXËNËSE, TIRANË

Më pas ata nxënësit e anketuar, që kanë pohuar se janë pyetur për cilësinë e teksteve shkollore, kanë pohuar se janë pyetur nga autoritetet arsimore (Shkolla, DAR, MASH) (39% e tyre); nga shtëpitë botuese (22% e tyre), nga vetë autorët e teksteve (10 %) dhe nga të tjerë aktorë (29% e tyre).

Grafiku 3.2 Kush ju ka marrë mendim për cilësinë e teksteve?




VJELJA E MENDIMIT TË MËSUESVE

Gjithashtu, përmes anketës online u pyetën edhe mësuesit nëse u është marrë mendim rreth problemeve/vështirësive që mund të kenë hasur gjatë përdorimit të teksteve shkollore. Rezultatet tregojnë se pjesës më të madhe të mësuesve të anketuar (76% e tyre) nuk u është marrë mendim. Vetëm 24% e tyre pohojnë t’u jetë marrë mendim mbi problemet e hasura me tekstet shkollore.

Për të gjurmuar ekzistencën e ndonjë mekanizmi të vjeljes së përshtypjeve janë pyetur mësuesit se kush i ka pyetur mbi cilësinë e teksteve shkollore. Kështu, 39.6% e mësuesve që pohuan se u është marrë mendim, deklarojnë se kjo është bërë përmes pyetësorëve/ anketave të përgatitura nga institucionet arsimore. 22.5% e tyre deklarojnë se mendimi u është marrë nëpërmjet takimeve me përfaqësues të institucioneve arsimore, 11.5% nëpërmjet takimeve

me përfaqësues të shtëpive botuese, 11% në takime me autorë tekstesh, 2.7% me pyetësorë/ anketa të përgatitura nga shtëpitë botuese dhe 12.6% në forma të tjera. Kjo mori aktorësh dhe kanalesh komunikimi tregon për mosekzistencën e një mekanizimi të njëjësuar që do të siguronte një grumbullim të standardizuar të të dhënave mbi problematikat e hasura me tekstet, sikundër dhe do të ofronte mundësi për të analizuar të dhënat në mënyrë që gjetjet të informojnë institucionet apo organet që kujdesen për sigurimin e cilësisë dhe certifikimin e teksteve.

Grafiku 3.3 Nëse ju është marrë mendim rreth vështirësive që keni hasur me tekstet shkollore, në cilën formë ju është marrë?



Të dhënat e evidentuara përmes anketës online, janë konfirmuar si nga fokus-grupet e organizuara me mësues, ashtu edhe nga intervistat e thelluara me drejtues të institucioneve arsimore. Kështu, nga pohimet e mësuesve pjesëmarrës në fokus-grupe kuptojmë se nuk ka një mekanizëm të mirëfilltë që funksionon për vjeljen e përshtypjeve të përdoruesve të teksteve, çka do të ndihmonte në përmirësimin e cilësisë. Sigurisht nisma të kompozuar dhe në baza spontane duket të jenë ndërmarrë nga aktorë të ndryshëm, por nisma të tilla përveçse janë të kufizuara, nuk mbështeten në një strukturë dhe procedurë të mirëfilltë, duke e bërë të paqartë ndikimin që mund të kenë në përmirësimin e teksteve gjatë vitit në vijim.

“Me vite, vërejtjet tona, problemet që mund të kemi pasur, bile dhe të mprehta, absolutisht nuk kanë shkuar gjëkund”.

MËSUESE, TIRANË

Mësuesit, të pyetur nëse diskutojnë në shkollë për problemet që kanë pasur gjatë përdorimit të teksteve, shprehen se përgjithësisht kanë një fletore të procesverbaleve në departament, ku shënohen të gjitha vërejtjet për tekstet, por ata, gjithashtu, shprehin shqetësimin se ato vërejtje mbeten vetëm aty, pa mundur të raportohen në institucionet eprorë.

Ndërkohë nga ky studim ka rezultuar se në disa qytete drejtoritë arsimore rajonale mbledhin mendime nga mësuesit lidhur me problemet që tekstet mësimore kanë, megjithatë këto raste nuk duket se janë të shpeshta, madje mësuesit pjesëmarrës në fokus-grupe shprehen skeptikë në lidhje me ndikimin që ato kanë.

“Madje sivjet përfaqësuesit e DAR-it na thanë të shkruanim arsyet se përse nuk e përzgjidhni këtë tekst, më mirë bëni këtë se sa e përzgjedh këtë tekst për këtë arsye. Më mirë nxirrni defektet, nuk e përzgjedh këtë për arsye se ka këto defekte sesa...”

NJË MËSUES NË KORÇË

VJELJA E MENDIMIT TË PRINDËRVE

Përmes anketës online prindërit u pyetën nëse gjatë vitit shkollor 2011-2012 u është marrë mendimi për cilësinë e teksteve shkollorë. Përgjigjet e tyre konfirmojnë se 95% e prindërve të anketuar shprehen se nuk u është marrë asnjëherë mendim dhe vetëm 5% e tyre deklarojnë të kundërtën.

Një e dhënë e tillë, që, gjithashtu, mbështetet edhe nga gjetjet e fokus-grupeve të zhvilluara me prindër, është shumë shqetësuese pasi tregon se në një shkallë të lartë prindërve nuk u merret mendimi për tekstet shkollorë, ndërkohë që një pjesë e madhe e prindërve (sidomos ata që i kanë famijët në shkollën fillore) janë përdorues të teksteve shkollorë së bashku me fëmijët e tyre.

“Jo, jo, asnjëherë nuk na kanë pyetur. Do të na kishte ardhur ndonjë anketë, nuk na ka ardhur”.

PRIND, KORÇË

Prindërit pjesëmarrës në fokus-grupe kanë treguar se nuk u është marrë mendim nga shtëpitë botuese, autorët e teksteve, apo institucionet arsimore për problemet që kanë dalë gjatë përdorimit të teksteve të fëmijëve të tyre, por që ata do të ishin të gatshëm të kontribuonin me eksperiencën dhe njohuritë e tyre.

“Mua s’më kanë marrë ndonjëherë mendim për Altertekstin, ndoshta në gjuhë dhe në matematikë nuk mund të jem eksperte, por te pjesa e anglishtes jam eksperte, është dega ime, atëherë unë në rolin e prindit po të ofroj ekspertizën time për të të thënë që kjo bën dhe kjo nuk bën. Madje në shumicën e rasteve as mësuesve nuk u merret mendim për Altertekstin.

PRIND, FIER

Gjithashtu, duke qenë se një pjesë e madhe e prindërve kanë shfaqur ankesa për cilësinë e disa teksteve shkollore, ata janë pyetur nëse kanë biseduar me mësuesin e lëndës për këtë gjë. Kështu, 75 % e prindërve të anketuar janë shprehur se kanë biseduar me mësuesin e lëndës. Ky rezultat është tregues i një interesimi dhe gatishmërie të lartë nga ana e prindërve për të dhënë opinionet e tyre mbi cilësinë e teksteve shkollore, çka lë vend për të menduar se mos vjelja e mendimit të prindërve më shumë se një neglizhencë nga ana e këtyre të fundit (siç është reklamuar shpesh nga drejtues të ndryshëm arsimorë) vjen për shkak të neglizhencës nga ana e institucioneve arsimore.

“Mbas miratimit nuk (diskutohet). Nuk ka pasur diskutime, të themi atë që është realiteti”.

PRIND, KUKËS


Nëse krahasojmë rezultatet e anketave online të zhvilluara me nxënës, mësues dhe prindër lidhur me faktin se sa u është marrë mendimi për cilësinë e teksteve, duket se më të përjashtuarit nga ky proces janë prindërit dhe më pas nxënësit, të cilët janë përdoruesit kryesorë të teksteve shkollore dhe mbajnë mbi supe pasojat e drejtëpërdrejta të papërshtatshmërisë së tyre shkollore.

QËNDRIMET E DREJTUESVE ARSIMOR

Mbasi janë vjelur mendimet e prindërve, mësuesve dhe nxënësve, studimi është përpjekur të mbledhë informacion më të thelluar përmes intervistave me përfaqësues të drejtorive arsimore rajonale, si dhe drejtues shkollash në 7 qytetet në fokus.

Kështu, sipas pohimeve të drejtuesve arsimorë të intervistuar (drejtues shkollash apo përfaqësues të DAR) rezulton se në disa raste (të rralla) drejtorja e shkollës mbledh përshtypjet e mësuesve për tekstet shkollore me të cilat ata kanë punuar gjatë vitit shkollor. Kryesisht kjo ndodh gjatë periudhës së përzgjedhjes së teksteve të reja. Megjithatë, në të gjitha rastet pohohet se edhe në ato raste kur merren mendime, pyeten vetëm mësuesit dhe se nuk bëhet fjalë për një mekanizëm për vjeljen e përshtypjeve sesa për një ndarje shqetësimesh brenda

A JU ËSHTË MARRË MENDIMI MBI CILËSINË E TEKSTEVE SHKOLLORE?



shkollës mes kolegësh, ndikimi i të cilës në përzgjedhjen e teksteve të ardhshme nuk njihet.

“Mekanizëm nuk ka, por mund të ketë ankesa të momentit, për shembull, që nuk e mësojmë dot mësimin, është i vështirë, nuk kuptohet, fjalët janë të vështira, të pakuptueshme, janë shumë filozofike, nuk merret vesh fjalia, ka gabime teksti et.j”

DREJTOR SHKOLLE, KORÇË

Studimi tregon se ka patur raste që në shkolla të caktuara janë zhvilluar nga vetë shkolla takime sporadike me nxënës, ku ata janë pyetur nëse u pëlqejnë apo jo tekstet shkollore, sikurse edhe raste të

shtëpive botuese që interesohen për cilësinë e teksteve të tyre. Megjithatë, duket se praktika të tilla janë realizuar vetëm disa vite më parë, kur filloi të zbatohet për herë të parë reforma e Altertekstit.

Studimi tregon se në sektorin e arsimit ka drejtues shkollash skeptikë, të cilët e shohin të panevojshme pyetjen direkte të nxënësve mbi cilësinë e teksteve, pasi në çdo rast shqetësimet e tyre përcillen nga mësuesit e lëndës, sikurse dhe drejtues të tjerë që mendojnë se duke qenë se mësuesit janë anëtarë të KPT-ve, ku ata mund të shprehin qëndrimet dhe opinionet e tyre, nuk është e nevojshme ngritja e ndonjë mekanizmi për vjeljen e përshtypjeve për cilësinë e teksteve shkollore.

“Me nxënës të klasave të ndryshme po, por janë përzgjedhur disa nxënës nga klasa. Disa nxënës jo shumë të mirë, por të niveleve të ndryshme. Përzgjedhjen e bëjmë ne, shohim regjistrin dhe themi ky, ky, ky nxënës”.

DREJTOR SHKOLLE, ELBASAN

“Mendimet e nxënësve na vijnë vetëm nëpërmjet mësuesve, sepse mësuesi konsiderohet si një relator në këtë aspekt dhe, me qenë se është relator, ne e marrim mendimin e nxënësit përmes mësuesit. Sa u takon prindërve, edhe ata kanë një bashkëpunim me mësuesit, sidomos me mësuesit kujdestarë të çdo klase dhe kjo është mënyra prej së cilës ne mund të vjelim informacion”.

DREJTOR SHKOLLE, FIER

“Mekanizmi më i saktë është nëse ato tekste përzgjidhen në vazhdimësi dhe shumë herë. Kur teksti përzgjidhet në vazhdimësi, do të thotë që ka qenë tekst që është pëlqyer dhe cilësia e tij ka qenë e mirë. Në rastet kur një tekst nuk është përzgjedhur më dhe pothuajse ka dalë nga qarkullimi, do të thotë se ky nuk është përzgjedhur më. Ky është treguesi më i mirë për të marrë vesh nëse një tekst ka qenë i suksesshëm apo jo.”

SPECIALIST, DAR FIER

Alterteksti dhe Matura Shtetërore

ENDRIT SHABANI

Në fokus të këtij studimi ka qenë edhe roli i Altertekstit në përgatitjen e maurantëve për provimet e Maturës Shtetërore. Ky aspekt ka qenë i rëndësishëm pasi maurantët e këtij viti janë përgatitur me tekstet alternative. Të dhënat e këtij studimi janë kryqëzuar edhe me të dhënat e një studimi tjetër, të zhvilluar paralelisht nga Programi i Arsimit i fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Kështu, ka rezultuar se, megjithëse programi mësimor duhet të jetë i përbashkët për të gjithë shkollat e mesme, maurantët dhe mësuesit janë të mendimit se kjo reformë e ka vështiresuar përgatitjen e maurantëve për provimet e Maturës Shtetërore (MSH), duke rritur pasigurinë e tyre për pyetjet e provimit. Pjesa dërrmuese e maurantëve dhe mësuesve të maturës të intervistuar shprehen se gjatë përgatitjes për provimet e MSH-së ata kanë punuar me tekste të ndryshme nga tekstet e shkollës së tyre, pasi tekstet e shkollës së tyre nuk pasqyrojnë informacion të plotë lidhur me përgatitjen për provimet e MSH-së. Pohimi i maurantëve (mbas provimeve të MSH-së) se, nëse do të kishin punuar vetëm me tekstet e shkollës së tyre, nuk do të kishin mundur t'u përgjigjeshin disa prej pyetjeve të provimeve të MSH-së, na bën të mendojmë se mungesa e një planifikimi të mirë ka bërë që Alterteksti të kthehet në pengesë sa i përket përgatitjes së maurantëve.

REKOMANDIME

Për procesin e vlerësimit dhe miratimit të teksteve

Në mënyrë që grupet e interesit të fitojnë besimin te reforma e Alterteksit, kërkohet një vëmendje e madhe nga ana MASH-it për një administrim sa më të mirë, duke nisur me rritjen e kontrollit në procesin e vlerësimit dhe miratimit të teksteve.

Për këtë arsye rekomandojmë, së pari, marrjen e masave nga ana e MASH-it, që në të gjitha KVT-të të përzgjidhen jo vetëm profesionistët më të zotë, por edhe ata me integritetin më të lartë.

Së dyti, në mënyrë që të garantohet respektimi i këtyre kriterëve, të bëhen publikë emrat dhe kontributi akademik (CV-të) e të gjithë anëtarëve të përzgjedhur në këto komisione. Shqetësimi i ngritur se publikimi i emrave të anëtarëve të KVT-ve rrit mundësinë për influencimin e tyre, nuk duket bindës, pasi aktualisht përbërjet e KPT-ve, të cilat kanë një rol po aq të rëndësishëm, janë publike. Nga ana tjetër, në kushtet aktuale të Shqipërisë, ata që konsiderohen si rreziku potencial (botuesit) për shkak të pozitës së tyre ekonomike, në shumë raste arrijnë të sigurojnë informacionin që ju nevojitet, duke bërë kështu që anëtarët e KVT-ve të qëndrojnë zbuluar përballë atyre prej të cilëve ruhen (botuesve), por të fshehur përballë atyre, të cilëve duhet t'u japin llogari për vlerësimet e tyre (mësuesve, prindërve dhe nxënësve).

Gjithashtu, MASH-i duhet të kujdeset që përmes KMT-së të garantojë miratimin me përgjegjësi të teksteve shkollore, pasi, nëse KMT-ja nuk do të lejonte miratimin e teksteve me gabime shkencore, apo tekste të një cilësie të dobët, atëherë nuk do të ekzistonte mundësia që KPT-të të përzgjidhnin një tekst të tillë, pasi ai nuk do të ishte në qarkullim. Në këtë kuadër rekomandojmë marrjen e masave në lidhje me riorganizimin e KMT-së. Nga ana tjetër, do të ishte e nevojshme ngritja e një ekipi teknik pranë KMT-së, që të lehtësonte punën e tij lidhur me proceset administrative. Nëse një ekip i tillë do të funksiononte me baza të përhershme, ai mund të ndiqte më së miri procesin e vlerësimit të teksteve, si dhe të administronte ankesat apo përshtypjet e grupeve të interesit.

Për më tepër rekomandojmë marrjen edhe të disa masave konkrete.

Së pari, rekomandojmë kufizimin e numrit të alternativave të miratuara për çdo tekst. Një numër më i vogël alternativash do t'u jepte mundësi mësuesve të shqyrtonin secilin prej tyre, si dhe do të rriste mundësinë e sigurimit të cilësisë së teksteve në vazhdimësi, përmes vjeljes së përshtypjeve të perdoruesve dhe pasqyrit të tyre në raporte zyrtare periodike për cilësinë e teksteve..

Së dyti, rekomandojmë që tekstet përpara se të miratohen nga KMT t'u nënshtrohen dy oponencave të pavarura, si një kusht i domosdoshëm për miratimin e mëtejshëm të tekstit.

Së treti, rekomandojmë marrjen e masave për vlerësimin e vetë shtëpive botuese, si dhe klasifikimin e tyre në bazë të cilësisë së botimeve dhe seriozitetit në përmbushjen e detyrimeve. Një klasifikim i tillë do të rriste përgjegjësinë e shtëpive botuese, por edhe do të ndihmonte mësuesit në përzgjedhjen e teksteve. Megjithatë, një rekomandim i tillë do të duhej të shoqërohej me kriteret dhe një proces transparent, në mënyrë që të mos kthehej në një instrument në dëm të konkurrencës së lirë dhe të ndershme.

Për procesin e përzgjedhjes së teksteve

Megjithëse KMT dhe KVT-të kanë një rol tepër të rëndësishëm në miradministrimin e Altertekstit, kjo nuk justifikon veprimtarinë e mësuesve anëtarë të KPT-ve, pasi KPT-të janë konceptuar pikërisht si filtri i dytë në garantimin e cilësisë së teksteve. Prandaj, nëse ata do ta bënin punën e tyre me korrektësi, nuk do të lejonin që tekste të një cilësie të dobët të përzgjidheshin në shkollat përkatëse. Nga ana tjetër, në një kohë që mësuesit, për shkak të mungesës së garancisë për karrierën e tyre, mund të mos jenë aktivë në denoncimin e problemeve me Altertekstin, nuk ka asnjë barrierë për prindërit që këta të luajnë një rol më aktiv, pasi janë pikërisht ata dhe fëmijët e tyre që paguajnë kostot e një keqadministrimi të mundshëm. Për këtë arsye angazhimi i prindërve në procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollorë, përveçse një detyrim ligjor, është edhe një garanci për integritetin e procesit dhe rezistencën ndaj ndikimeve të mundshme.

Duke sjellë në kujtesë faktin që Altertekst u hartua pikërisht për t'i dhënë mundësi mësuesit të zgjedhë tekstin shkollor më të përshtatshëm për nxënësit e shkollës së tij, do të vlerësonim që, nga krijimi i KPT-ve mes mësuesve të disa shkollave, të shkohet drejt KPT-ve vetëm me mësuesit e së njëjtës shkollë. Një zgjidhje e tillë nga njëra anë do të fuqizonte votën (dhe për pasojë rolin) e secilit mësues, pasi KPT-të do të përbëheshin nga më pak anëtarë, por nga ana tjetër nuk do linte jashtë asnjë prej mësuesve. Gjithashtu, një gjë e tillë do të ushqente komunikimin dhe bashkëpunimin e mësuesve të shkollës gjatë gjithë vitit shkollor. Një hap i tillë do të vendoste në një shkallë më të lartë përgjegjësi stafin pedagogjik të shkollës përballë komunitetit të nxënësve dhe prindërve.

Gjithashtu, rekomandojmë që MASH-i, përmes DAR/ZA t'i kushtojë një vëmendje më të madhe procesit të realizimit të mbledhjeve të KPT-ve, si dhe mbajtjes së procesverbaleve të takimit, çka ndihmon në rritjen e transparencës, duke rritur trysinë dhe kontrollin ndaj procesit.

Së fundmi, duke u nisur nga problemet e evidentuara më sipër në lidhje me shqyrtimin e alternativave nga ana e mësuesve anëtarë të KPT-ve, mendojmë se do të ishte me shumë rëndësi që vetë autorët e teksteve të bëjnë një prezantim të teksteve të tyre. Duke qenë se aktualisht çdo shkollë i ka mundësitë teknike (kompjuter me internet), do të rekomandonim marrjen e masave nga ana e MASH-it për të siguruar një prezantim audiovizual për çdo alternativë gjatë mbledhjeve të KPT-ve. Një prezantim i tillë do të ndihmonte në procesin e përzgjedhjes së teksteve më të mira për nxënësit.

Mekanizmi i vjeljes së përshtypjeve

Siç është përmendur edhe më sipër, pjesëmarrja e prindërve (kryesisht në arsimin fillor) në procesin e përzgjedhjes së teksteve është e një rëndësie të madhe, duke qenë se do të jenë pikërisht fëmijët e tyre që do të mësojnë me këto tekste. Për këtë arsye një mekanizëm i vjeljes së përshtypjeve dhe eksperiencave me tekstet shkollore, si të nxënësve, ashtu dhe të prindërve, do të ndihmonte mësuesit në vitin pasardhës për të bërë një përzgjedhje më të mirë. Një gjë e tillë do të kontribuonte në përzgjedhjen e teksteve më të mira nga viti në vit. Për sa më sipër rekomandojmë që MASH-i të marrë masa për të ngritur një mekanizëm të përhershëm të vjeljes së përshtypjeve dhe eksperiencave për tekstet shkollore, i cili të jetë i shtrirë në nivel kombëtar. Rekomandojmë, gjithashtu, që vlerësimi pozitiv në një shkallë të lartë të vendoset si një parakusht për rizgjedhjen ose jo të një teksti në vitin pasardhës. Një hap i tillë do të ndante peshën e vendimmarrjes midis komisioneve përzgjedhëse të teksteve dhe përdoruesve të tyre (mësuesit, nxënësit dhe prindërit).

Analizë krahasimore e Altertekstit gjatë tri viteve të fundit (2010 – 2012)

NGA ENDRIT SHABANI

GJETJE TË STUDIMEVE NDËR VITE TË OSFA

A) PËRZGJEDHJA E TEKSTEVE

Përbërja e komisioneve përzgjedhëse të teksteve

Në vitin 2010 ka rezultuar se mbi 50% e KPT-ve janë përbërë nga mbi 10 anëtarë, një numër ky që në vitin 2012 ka rezultuar 5-7 anëtarë, si pasojë edhe e ndryshimeve në kuadrin rregullues. Një zvogëlim i numrit të anëtarëve të KPT-së nga një pikëpamje shikohet si një hap pozitiv, pasi nga njëra anë i jep më tepër peshë votës së secilit mësues dhe nga ana tjetër jep më shumë hapësirë për diskutim gjatë mbledhjeve të KPT-ve. Megjithatë, gjatë vitit 2012 ky hap ndonjëherë është marrë me koston e mospërfshirjes së disa prej mësuesve në asnjë prej KPT-ve, çka në fakt është krejt e kundërta e qëllimit fillestar.

Pjesëmarrja e prindërve

Megjithëse nga grupet e interesit është shprehur qart rëndësia e madhe që ka prania e prindërve në procesin e përzgjedhjes së teksteve, gjatë këtyre tri viteve vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre kanë mundur të bëhen pjesë e KPT-ve. Kështu, pa ndonjë ndryshim paraqitet situata gjatë tri viteve të fundit, kur në vitin 2010 raportohet se vetëm 2 në çdo 10 KPT (për çdo qytet të monitoruar në atë periudhë) kanë pasur në përbërjen e tyre nga një prind. Po ashtu 80% e mësuesve të anketuar në vitin 2011 konfirmojnë se në KPT-të ku ata kanë marrë pjesë nuk kishte prindër të pranishëm. Një situatë e tillë është konfirmuar edhe në vitin 2012, kur megjithëse tashmë një detyrim ligjor, pjesëmarrja e prindërve mbetet në nivele tepër të ulta (vetëm 4 % e prindërve të anketuar konfirmojnë të kenë qenë pjesë e KPT-ve).

Trajnimi i mësuesve

Gjatë vitit 2010 dhe vitit 2011 është marrë në shqyrtim çështja e trajnimit të mësuesve, duke qenë se ishin edhe dy vitet e para të aplikimit të Altertekst. Nga monitorimi gjatë këtyre viteve ka rezultuar se në vitin 2010 vetëm 49% e mësuesve të anketuar pranonin të kishin marrë pjesë në trajnim për funksionimin e KPT-së. Kjo shifër ka qenë 60% në vitin 2011, duke treguar që vit mbas viti gjithnjë e më pak vëmendje i është kushtuar trajnimit të mësuesve.

Mbledhjet e KPT-ve dhe përzgjedhja e teksteve

Për sa i përket funksionit të KPT-ve dhe marrjes së vendimit për përzgjedhjen e teksteve duket se pak ka ndryshuar gjatë këtyre tri viteve të fundit. Të njëjtat probleme që raportoheshin në studimin e vitit 2010, siç janë: *mospajisja e secilit mësues me çdo tekst alternativ, koha e pamjaftueshme në dispozicion për të shqyrtuar alternativat dhe cilësia e diskutimit në mbledhjet e KPT-ve*; raportohen në mënyrë të përsëritur edhe në dy studimet e ndërmarra në vitin 2011 dhe 2012. Për pasojë në të tria vitet ka rezultuar se një pjesë e madhe e mësuesve nuk i lexojnë të gjitha alternativat e mundshme përpara se të votojnë për to, duke vënë kështu në pikëpyetje shkallën e seriozitetit dhe profesionalizmit të procesit të përzgjedhjes së teksteve shkollore.

Ndikimi i mësuesve

Viti 2010, që ishte edhe viti i parë i zbatimit të Altertekstit, dukej shumë optimist sa i përket forcës vendimmarrëse të vetë mësuesve. Kështu 88% e mësuesve të anketuar në vitin 2010 deklarorin se ishin të pandikuar për zgjedhjen e tekstit shkollor. Ndërkohë që në vitin 2012 (dy vjet më pas) duket se nuk është ruajtur e njëjta panoramë, pasi vetëm 55 % e mësuesve të anketuar pohojnë se nuk ka pasur ndikim, ndërsa pjesa tjetër (45 %) deklarorin të kundërtën. Gjithashtu, këto rezultate janë mbështetur edhe nga pohimet e mësuesve pjesëmarrës në fokus- grupe, të cilët në shumë raste kanë deklaruar se ata kanë marrë udhëzime për të përzgjedhur tekste të caktuara. Ndikime të tilla janë shqetësuese pasi në të shumtën e rasteve ato e detyrojnë mësuesin të lëshojë nga bindja e tij e brendshme, duke zgjedhur një tekst shkollor jo cilësor.

B) CILËSIA E TEKSTEVE

Problemet e hasura me tekstet shkollore

Duket se janë të njëjtat lëndë në të cilat nxënësit hasin vështirësi. Kështu, si në vitin 2010, ashtu edhe në vitin 2012 lëndët problematike janë Matematika dhe Gjuha Shqipe.

Për sa i përket asaj se çfarë problemi shfaqin këto tekste, edhe këtu duket se asgjë nuk ka ndryshuar përgjatë viteve. Kështu, për dy vite radhazi (2011 dhe 2012) nxënësit kanë renditur problemet me tekstet shkollore në mënyrë identike. Problemi i parë i renditur sipas rëndësisë është *dija në tekst*, e cila është e një niveli më të përparuar se mosha e nxënësit; problemi i dytë është *gjuha e përdorur*, e cila konsiderohet nga nxënësit si e pakuptueshme; dhe së fundi, nxënësit rendisin vleresimin se *dija e paraqitur në tekstin shkollor nuk është praktike* dhe se shpesh mungojnë shembujt ilustrues.

Një renditje identike për dy vite radhazi përveçse përforcon vërtetësinë e gjetjeve të studimeve, tregon për më tepër qëndrueshmërinë e këtij problemi, duke treguar edhe një herë se ku duhet ndërhyrë për rritjen e cilësisë së teksteve.

Roli i cilësisë në procesin e të mësuarit

Një pjesë e konsiderueshme e nxënësve, por edhe e prindërve të tyre kanë konfirmuar në të tria studimet se kanë hasur vështirësi në përvetësimin e mësimeve. Nga pohimet e tyre vërehet se arsyeja kryesore përse nxënësit hasin vështirësi në mësime mbetet e njëjtë në të tria vitet. Kështu, rezulton se 60 % e të anketuarve në vitin 2010, 44 % në vitin 2011 dhe 36 % në vitin 2012 e kanë për zgjedhur “Cilësinë e dobët të teksteve shkollore” si arsyen kryesore që vështirëson mësimnxënien e nxënësve. Megjithatë cilësia e dobët e teksteve shkollore mbetet problem i parë për nxënësit dhe prindërit e tyre, duhet theksuar se, referuar shifrave, vërehet një tendencë pozitive nga viti në vit, gjë që nuk jep garanci për një përmirësim të cilësisë së teksteve nga njëri vit në tjetrin (gjë që konfirmohet nga paragrafi i mëposhtëm), por mund të jetë sinjal se renditja e shkaqeve të vështirësive në të nxënë mund të ketë ndryshuar pasi parametra të tjerë të mësimdhënies mund të jenë përkeqësuar.

Ecuria e cilësisë së teksteve

Për sa i përket ecurisë së cilësisë së teksteve janë krahasuar përgjigjet e prindërve gjatë studimeve të vitit 2010, 2011 dhe 2012. Kështu, duket se vlerësimet pozitive të vitit 2010, ku 43.8 % e prindërve deklarorin se cilësia e teksteve kishte ardhur duke u përmirësuar, në vitet pasardhëse situata paraqitet krejt ndryshe. Kështu vetëm 19% e prindërve të anketuar në vitin 2011 dhe 12 % në vitin 2012 janë shprehur se cilësia e teksteve ka ardhur duke u rritur. E njëjta tendencë vërehet edhe në përgjigjet e nxënësve. Nëse në vitin 2011, 32 % e tyre shikonin përmirësim në cilësinë e teksteve shkollore, vetëm 24 % pohojnë një gjë të tillë një vit më pas (në vitin 2012).

Një analizë e tillë mund t'i jap shkas arsyetimit se reforma e Altertektit nuk po arrin të përmbushë pritshmëritë e prindërve për tekste shkollore më cilësore nga viti në vit, kjo edhe për shkak të mungesës së mekanizmit të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit të saj duke marrë në konsideratë përshtypjet e përdoruesve.

C) MEKANIZMI I PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË

Përdoruesit e teksteve

Përdorues të drejtpërdrejtë të teksteve janë mësuesit dhe nxënësit, por në shumë raste janë edhe prindërit e tyre, të cilët i ndihmojnë në përgatitjen e mësimeve. Kështu, është konsideruar e rëndësishme vjelja e mendimeve të këtyre përdoruesve mbi cilësinë e teksteve shkollore, në mënyrë që këto mendime të ndihmojnë në përmirësimin e teksteve në të ardhmen.

Nga rezultatet e studimeve të ndërmarra gjatë këtyre tri viteve të fundit, rezulton se situata ka ardhur duke u përkeqësuar sa i përket vjeljes së përshtypjeve të përdoruesve të teksteve, për cilësinë e këtyre të fundit. Kështu, ka rezultuar se, nëse në vitin 2010 gjysma e mësuesve

të anketuar (50 %) deklarorin se ishin pyetur për cilësinë e teksteve shkollore, në vitin 2011 kjo shifër ishte 43 %, për të shkuar në 24 % gjatë vitit të fundit (2012).

E njëjta situatë paraqitet edhe për nxënësit, të cilët, gjithësesi, gjatë tri viteve janë pyetur shumë më rrallë se mësuesit. Nëse në vitin 2011 ishin 14 % e nxënësve të anketuar, që deklarorin se ishin pyetur mbi cilësinë e teksteve me të cilat ata mësonin, në vitin 2012 vetëm 8 % e tyre pohorin të njëjtën gjë.

Edhe më pesimiste paraqitet situata për sa u përket prindërve. Nëse në vitin 2010 ishin 12% ata që deklarorin se ishin pyetur mbi cilësinë e teksteve shkollore me të cilat mësonin fëmijët e tyre, në dy vitet e fundit kjo shifër ka qenë e përgjysmuar (respektivisht 6 % në vitin 2011 dhe 5% në 2012).

Po t'i referohemi prirjes që shfaqin shifrat, është e qartë se nga viti në vit janë pyetur më pak mësues, më pak nxënës dhe më pak prindër për cilësinë e teksteve. Në një kohë që një pjesë e madhe e tyre raportojnë për probleme me tekstet, vihet në pikëpyetje shkalla e interesit që kanë institucionet arsimore dhe subjektet private, përgjegjëse për cilësinë e teksteve, me të cilat mësojnë nxënësit e sotëm.

Subjektet e interesuara për mendimet e përdoruesve

Për sa u përket subjekteve që kanë treguar interes për mendimet e përdoruesve të teksteve, në ato raste ku janë deklaruar se ka ekzistuar një përvojë e tillë (pra është vjelur mendimi), ato kanë qenë kryesisht institucionet arsimore (DAR /ZA), si dhe shtëpitë botuese apo autorët e teksteve. Megjithatë, nëse në vitin 2010 kishte një farë angazhimi nga ana e shtëpive botuese dhe/apo autorëve të teksteve, duket se me kalimin e viteve interesimi i tyre ka ardhur duke rënë (duke krahasuar gjetjet e studimeve të vitit 2010 me studimet e vitit 2011 dhe 2012). Kjo rënie interesi nga ana e shtëpive botuese mund të ketë shumë arsye, por në çdo rast nuk përkon me logjikën e thjeshtë të konkurrencës, pasi, nëse ato (shtëpitë botuese) do të udhëhiqeshin nga konkurrenca e drejtë dhe e ndershme, të cilën duhet ta garantojë MASH-i, do të duhej që të tregonin më tepër interes të paktën për mësuesit të cilët janë pikërisht ata që vendosin se me cilin tekst do të mësojnë nxënësit.

Nga ana tjetër duket se, edhe pse interesi është më i ulët se në vitin 2010, institucionet arsimore (kryesisht DAR dhe ZA) në mënyrë të përsëritur (më shumë sporadike se periodike) kërkojnë mendime dhe opinione nga mësuesit e lëndës mbi ecurinë e teksteve që ato kanë përzgjedhur dhe nëse është raportuar ndonjë problem me to.

Mekanizmi i përdorur

Për sa i përket mekanizmit të vjeljes së përshtypjeve, nëse në vitin 2010 pjesa më e madhe e mësuesve dhe nxënësve do të rendisnin pyetësorët (të parët) dhe takimet me përfaqësues të DAR apo shtëpive botuese, në vitin 2012 duket se edhe në ato raste kur merren mendimet e grupeve të interesit, kjo ka më shumë gjasë të bëhet përmes takimeve (me nxënës ose mësues) sesa përmes pyetësorëve. Bisedat janë një rrugë e mirë e vjeljes së përshtypjeve, por

duhet theksuar fakti se pyetësorët përbëjnë një mekanizëm më frytdhënës në mbledhjen e të dhënave në një shtrirje më të gjerë, sikundër bëjnë të mundur analizimin e plotë të tyre për të siguruar informacion objektiv dhe të dobishëm.

Situata do të ishte me pozitive nëse ndryshimet në Paketën Informuese Altertekst 2012 sa i përket rolit që u është lënë KPT-ve si komisione oponente për cilësinë gjatë vitit shkollor do të zbatoheshin me rigorozitet në të gjitha shkollat e vendit, ose të paktën në një pjesë të konsiderueshme të tyre.

REKOMANDIMET NDËR VITE TË OSFA

Programi i Arsimit në fondacionin **Shoqëria e Hapur për Shqipërinë**, që prej vitit 2010 ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e teksteve alternative, duke synuar së pari të informojë publikun mbi ecurinë e kësaj reforme në nivel kombëtar, por mbi të gjitha të ndihmojë në fuqizimin e praktikës së njohur si “politika e bazuar mbi evidenca”. Kështu, çdo vit i janë ofruar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës rekomandime konkrete për hapat që mund dhe duhet të ndërmerren për t’u prerë rrugën abuzimeve dhe për të rritur në përgjithësi efektshmërinë e kësaj reforme. Megjithatë është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm me përfaqësues të MASH-it, sërisht një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve që janë dhënë gjatë vitit 2010 dhe vitit 2011 nuk janë pasqyruar në aktet administrative të kësaj ministrie apo institucioneve në varësi.

Sidoqoftë, disa prej rekomandimeve që janë marrë parasysh në vitet pasuese, duke u reflektuar në Paketën Informuese të Altertekstit apo akte të tjera nënligjore rradhiten si më poshtë:

1. Rekomandimi për vlerësimin e teksteve.

Për dy vite radhazi është rekomanduar nga OSFA që anëtarët e komisionit të vlerësimit të teksteve duhet të jenë të pavarur nga njëri-tjetri pasi ndikohen në vlerësimin e tyre. Gjithashtu, anëtarët duhet të kenë në dispozicion instrumente të gatshme dhe të detajuara për vlerësim.

2. Rekomandimi për trajtimin e kulturës së minoriteteve.

Për dy vite me radhë OSFA ka rekomanduar që KVT-të gjatë vlerësimit të teksteve të marrin në konsideratë, duke e përfshirë në kriteret vlerësuese, paraqitjen nga ana e teksteve shkollore sa më realiste të kulturës, historisë dhe traditave të minoriteteve që gjenden në Shqipëri, duke përfshirë edhe komunitetin Rom.

3. Rekomandimi për kohën në dispozicion për shqyrtimin e alternativave.

Për dy vite radhazi OSFA ka rekomanduar që MASH-i t’u lërë mësuesve më tepër kohë në dispozicion për të shqyrtuar të gjitha alternativat që i paraqiten, duke bërë që mësuesit të

njohin mirë alternativat përkatëse përpara se të votojnë për to.

4. Rekomandimi për përfshirjen e shkollës në procesin e shpërndarjes së librave.

Në vitin 2010 OSFA ka rekomanduar që shkolla të marrë një rol më të madh në procesin e shpërndarjes dhe tregtimit të teksteve shkollore.

5. Rekomandimi për monitorimin nga IKAP

Për dy vite me radhë është rekomanduar nga OSFA që, ndërkohë që ecuria e përzgjedhjes së teksteve të administrohet nga DAR, monitorimi i kësaj reforme të bëhet nga Inspektoriati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar.

6. Rekomandimi për ndërtimin e KPT-ve bazuar në nivelin e cilësisë së shkollave

Në vitin 2011 është rekomanduar nga OSFA që gjatë formimit të KPT-ve të merret në konsideratë edhe niveli i cilësisë së shkollave pjesëmarrëse.

7. Rekomandimi për shpërndarjen e teksteve falas për fëmijët Rom

Në vitin 2011 është rekomanduar nga OSFA ndërtimi i një mekanizimi dhe procedure standarde shpërndarjeje të teksteve falas për fëmijët romë, pra zëvendësimi i formes së rimbursimit të pagesës së teksteve, gjë që e nderlikonte procesin sidomos për familjet më të varfra.

Gjithashtu, janë marrë në konsideratë pjesërisht dy rekomandime të tjera:

8. Rekomandimi për pjesëmarrjen e prindërve në KPT

Për dy vite radhazi është rekomanduar nga OSFA që në mbledhjet e komisioneve përzgjedhëse të teksteve të shtohen edhe prindërit, të cilët të përbëjnë 30% të anëtarëve të KPT, si dhe të kenë të drejtë vote.

Ky rekomandim është pasqyruar pjesërisht në paketën informuese Altertekst 2012, duke lejuar pjesëmarrjen e prindërve në mbledhjet e KPT-ve, por vetëm si vëzhgues, pra pa të drejtë vote.

9. Rekomandimi për zvogëlimin e numrit të KPT-ve

Është rekomanduar nga OSFA që, ose t'i jepet mundësia çdo mësuesi të zgjedhë tekstin me të cilin do të punojë gjatë vitit, ose të paktën KPT-të të përbëhen nga më pak anëtarë.

Ky rekomandim është pasqyruar pjesërisht në Paketën Informuese 2012, duke e ulur numrin e anëtarëve të KPT-ve nga komisione me mbi 10 mësues në komisione në 5-7 mësues.

FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË

Rr. Qemal Stafa, Pallati 120/2, Tirana, Albania

Tel: +355 4 22 34 621 / 22 34 223 / 22 35 856

Fax: +355 4 22 35 855

E-mail: info@soros.al

Web-page: www.soros.al

